

Akt Themelimi
I shoqerise me pergjesi te kufizuar

Dt 11/1/2024

I shoqerise tregtare **GENERAL SOLUTION SH.P.K**

Mbeshtetur ne Kushtetuten dhe Kodin Civil ne Fuqi te Republikes se Shqiperise , ne ligjin Nr.7512 date 10.08.1991 “ Per sanksionimin dhe mbrojtjen e prones private , nismes se lire dhe te veprimtarise private dhe privatizimit” , te ligjit Nr. 9901 date 14.04.2008 , “ Per shoqerite tregtare” dhe te ligjit Nr.9723 , date 03.05.2007 “Per Q.K.R dhe formalitetet qe duhen respektuar nga Shoqerite Tregtare , me vullnetin tim te lire , te shprehur edhe ne nenshkrimin e ketij akt-themelimi une ortaku : **Marko Hysolli** individ me pergjegjesi te kufizuar, banues ne Cerrik Elbasan , krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar **GENERAL SOLUTION SH.P.K** me akt themelimi si vijon :

Formulimi

Neni 1

Une **Marko Hysolli**, i biri i Gezim dhe Selvi , i datelindjes 06.07.1998.lindur ne Cerrik e banues ne Cerrik Elbasan , madhor dhe i afte per te kryer funksione juridike , i pajisur me Leter njoftimin numer 032999810 dhe numer personal J80706016I me vullnetin tim te lire vendosa te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar si me poshte vijon:

Formohet shoqeria tregtare private e quajtur **GENERAL SOLUTION SH.P.K** Shoqeria do ti nenshtrohet:

legjislacionit Shqiptar , ndersa deget qe mund te krijohen do ti nenshtrohen legjislacionit ku do te kete seline dega . Shoqeria do te ushtroje veprimtarine e saj ne baze te ketij akti themelues dhe statutit te shoqerise qe do te miratohet nga ortaket themelues .

Selia e Shoqerise

Neni 2

Selia e shoqerise tregtare private **GENERAL SOLUTION SH.P.K** do te jete me adrese prane Cerrik Elbasan rruga Cerrik Gostime Zone Kadastrale 2559 nr pasurie 64/22.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj , te hape zyra perfaqesie , dege , te krijojje filiale si brenda ashtu dhe jashte Republikes se Shqiperise , vetem me vendim te asamblese dhe ortakut te vetem .



Objektivi I Veprimtarise

Neni 3

Ne fushen e ndertimit Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, per realizimin te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose mirembajtje dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: Gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime, kompletimi me struktura dhe finitura të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadash. Ndertim, sistemime, mirembajtje e sherbim per; Rrugë, autostrada, ura, tunele, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhë me kavo dhe pista aeroportuale, sheshet të realizuara me materiale të veçanta, natyrale dhe artificiale, urat, si dhe komplekse karakteristikash teknike, në hekur, betonarme, parafabrikat ose të prodhuar në objekt te marr edhe te jap pune jashte territorit te Republikes se Shqiperis

Industri veshjeje, import-eksport, tregtim dhe shitje me pakice e shumice te mallrave, sipermarrje dhe sherbime ne fusha te ndryshme. Shitje me shumice e pakice e tekstileve, veshjeve, veshjeve sportive, kepuceve dhe artikujve te lekures neper panaire, stenda, tregje e dyqane te specializuara. Import, eksport, shitje me shumice dhe pakice e lodrave duke perfshire por pa u kufizuar ne: lodra dhe figura te licencuara dhe lojera me plasteline. Gjithashtu, ne perputhje me legjislacionin Shqiptar, Shoqeria mund te kryeje dhe realizoje çdo aktivitet qe lidhet direkt ose indirekt, qe eshte pasoje, apo e lidhur me aktivitetet e listuara me lart. Per te arritur qellimin e mesiperm, shoqeria mund te ndermarre cdo aktivitet dhe sherbim qofte tregtar, financiar, per dhenie me qira, opo hipotekim, qe mund te konsiderohet i dobishem apo i nevojshem ne menyre qe te arrihet objekti i shoqerise etj.



Kohezgjatja e Shoqerise

Neni 4

Shoqeria e formuar do te kete kohezgjatjen e veprimtarise se saj me nje afat te pacaktuar mbi 5 vjet duke filluar nga dita e pershtatjes se aktit te themelimit dhe statutit te saj.

Kapitali I Shoqerise

Neni 5

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 1.000.000 (Nje milion lek). I perbere nga kontributi i ortakut themelues **Marko Hysolli** me 100% kontribut.

Vlera e kapitalit themeltar ndahet ne 1 pjese (1kuota)

Kapitali themelues mund te ndryshoje sipas vendimit qe mund te marre ky ortak, por asnjehere nuk mund te pakesohet nen nivelin e e kapitalit themeltar fillestar te shoqerise .

Kapitali eshte teresisht i shlyeshem e i nenshkrueshem.

Çdo kuote i takon e drejta e nje vote.

Drejtimi I Shoqerise

Neni 6

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj , ortakut i vetem dhe perfaqesuesi ligjor saj .

Ai eshte perfaqesuesi i Shoqerise ne marredhenie me te tretet dhe ka kompetenca te plota ne drejtimin e saj .

Çdo kontrate do te kryhet prej tij dhe ne rast mungese nga nje perfaqesues i pajisur me prokure te posacme .

Neni 7

Te ardhurat neto te shoqerise i takojne ortakut te vetem .

Neni 8

Ortakut i vetem themelues ka te drejte te emeroje dhe administratore te tjere te vlerave materiale.

Ka te drejte te caktoje financiere , likuidatore per problemet e shoqerise si dhe te pajtoje persona te tjere si ortake .

Neni 9

Konfliktet qe mund te lindin do te zgjidhen ne zbatim te legjislacionit Shqipetar ne Gjykatën e Rethit Gjyqesor Elbasan .

Neni 10

Shoqeria ka vulen e saj me madhesi te zakonshme , me tekstin rreth saj .

Neni 11

Shoqeria deklarohet e krijuar ne zbatim te plote te normave te statutit dhe ne perputhje me legjislacionin Shqiptar ne fuqi dhe vecanerisht te Ligjit Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Krijimin e Shoqerive Tregtare" , si dhe duke zbatuar ligjet nderkombetare dhe te vendit si dhe rregullave qe zbatohen per biznesin qe kryen kjom shoqeri .

Neni 12

Akti I themelimit u perpilua ne kater kopje me nga tre flete secila, per t'ju shperndare organeve kompetente dhe nje kopje do te mbetet ne dokumentacionin baze te shoqerise **GENERAL SOLUTION SH.P.K**
Akti i themelimit nenshkruhet rregullisht nga ortaku i vetem .

Ortak i vetem themelues i shoqerise GENERAL SOLUTION SH.P.K

Marko Hysolli

MARKO HYSOLLI

